



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

ГЈУКАТА КУШТЕТУЕСЕ

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 10 gusht 2015  
Nr. i ref.: RK 819/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI180/14

Parashtrues

**Fehmi Pajaziti**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CPP. nr. 5/2014, të 9 shtatorit 2014

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga z. Fehmi Pajaziti, nga fshati Hajvali, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës e konteston Aktvendimin (CPP. nr. 5/2014, të 9 shtatorit 2014) e Gjykatës Supreme të Kosovës, nëpërmjet të cilit ishte refuzuar kérkesa e tij për përsëritje të procedurës lidhur me padinë që kishte iniciuar për kompensimin e një shume të caktuar të mjeteve financiare.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kérkesës më 31 tetor 2014.

## Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht “*nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojta e Pronës] në lidhje nenin 1 të Protokolloit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeritu* (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)“.

## Baza juridike

5. Kérkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 dhjetor 2014, parashtruesi parashtrroi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI180/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI180/14, caktoi Kolegjin shqyrtyues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 20 janar 2015, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës si dhe i dërgoi një kopje të kérkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 8 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtyues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kérkesën të papranueshme.

## Përbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës vërehet se parashtruesi ishte i punësuar në Korporatën Energetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK), pa u përmendur se në çfarë pozicioni ishte i punësuar.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për pension të parakohshëm invalidor pranë KEK-ut.
12. Më 1 nëntor 2008, KEK-u (Vendimi nr. 171/133) miratoi kërkesën e parashtruesit për pension të parakohshëm invalidor, si dhe pranoi që në emër të këtij pensioni t'ia paguajë parashtruesit një shumë të caktuar të mjeteve financiare në muaj, duke filluar nga 1 nëntori 2003 deri më 1 dhjetor 2008.
13. Pas 1 dhjetorit 2008, KEK-u ndaloi së paguari shumën e caktuar të mjeteve financiare.
14. Si rrjedhojë e këtij veprimi të KEK-ut, parashtruesi parashtroi padi kundër kësaj të fundit në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Ai kërkoi kompensim të pagesave mujore për vazhdimin e pensionimit invalidor, nga 1 dhjetori 2008 deri më 30 tetor 2009, respektivisht, deri në ditën kur parashtruesi hyn në kategorinë e pensionit të pleqërisë.
15. Më 2 nëntor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C1. nr. 423/2008) miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të bazuar, dhe detyroi KEK-un që t'ia paguajë parashtruesit shumën e kërkuar të mjeteve financiare me kamatë ligjore përkatëse. Sipas Gjykatës Komunale, KEK-u kishte ndërprerë pagesën mujore në mënyrë të kundërligjshme.
16. KEK-u parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
17. Me 22 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 618/2010), e refuzoi ankesën e KEK-ut si të pabazuar dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
18. Kundër këtij aktgjykimi, KEK-u parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme “*për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale*”, me propozimin që të ndryshohen dy vendimet e gjykatave më të ulëta, dhe që kërkesëpadia e parashtruesit të refuzohet si e pabazuar.
19. Më 26 shtator 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 262/12) pranoi, si të bazuar kërkesën për revizion të KEK-ut, dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe atë të Gjykatës Komunale, si dhe refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme theksoi:

*“[...] një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, sepse vlersimi i kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, gabimisht është zbatuar e drejta materiale.*

*Nga Vendimi nr. 171/133, datë 23.10.2003, rrjedh se paditësi [parashtruesi] vetë ka aplikuar për fitimin e pensionit-invalid kategoria 1, dhe sipas këtij vendimi pagesa e pensionit ka filluar nga data 01.11.2003 dhe përfundon me 01.12.2008.*

*Gjykata Supreme vlerëson se pas pagesës së kësaj page në kohëzgjatje prej 60 muaj, e padituara [KEK-u] më tutje nuk ka asnjë obligim, ngase ka përbushë obligimin ligjor i cili rrjedh nga vendimi i cekur. [...].*

20. Më 20 shkurt 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Supreme.
21. Më 9 shtator 2014, Gjykata Supreme (Aktvendim CPP. nr.5/2014) refuzoi, si të pabazuar kërkesën e paditësit, për përsëritje të procedurës, me arsyetimin se:

*[...] Paditësi kërkesën (propozimin) për përsëritjen e procedurës e ka paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së të drejtës të ndërprerjes së pensionit invalidor, të cilat si bazë ligjore nuk janë paraparë me asnjë dispozitë ligjore për mjetin e jashtëzakonshëm të përsëritjes së procedurës.*

*Neni 232 i LPK-së [Ligji për Procedurën Kontestimore] parashev se procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të Gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës sipas pikave a, b, c, d, e, f dhe g, të nenit të cekur, dhe sipas kësaj kërkesë të parashtruesit për përsëritjen e procedurës nuk është plotësuar asnjëri prej kushteve ligjoretë parapara me nenin e cekur”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtën në mbrojtje të pronës, siç garantohen me Kushtetutë, respektivisht KEDNJ.
23. Parashtruesi nuk jep ndonjë sqarim shtesë lidhur me këto pretendime. Ai vetëm paraqet një përshkrim të fakteve në kërkesën e tij, dhe më pas i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

*[...] të aprovohet kërkesa dhe të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Supreme CPP nr. 5/2014 dhe Aktgjykimi Rev. nr. 262/12”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

## Rregulli 36 i Rregullores së punës

*[...] (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

26. Gjykata rikujton se parashtruesi konteston Aktvendimin (CPP. nr. 5/2014, të 9 shtatorit 2014) e Gjykatës Supreme, me pretendimin se me anë të tij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe e drejta për mbrojte të pronës, të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
27. Në të vërtetë, parashtruesi vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se i janë shkelur këto të drejta dhe kérkon që të anulohet vendimi i kontestuar, si dhe Aktgjykimi (Rev. nr. 262/2012, i 26 shtatorit 2012) i Gjykatës Supreme.
28. Gjykata vëren se në kërkesën e tij, parashtruesi nuk ka dhënë asnë arsyetim procedural ose material; ai vetëm pohon pretendimet e lartpërmendura, pa shpjeguar më tej se si kanë ndodhur ato shkelje.
29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se fillimi, Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kishin miratuar kërkesëpadinë e parashtruesit dhe kishin urdhëruar KEK-un që të bëjë pagesat për muajt që ishin kontestues, përkatësisht nga 1 dhjetori 2008 deri më 30 tetor 2009.
30. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme (Rev. nr. 262/2012, i 26 shtatorit 2012) kishte pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga KEK-u, në cilësinë e të paditurës, si dhe kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit. Me atë rast, Gjykata Supreme kishte konsideruar se gjykatat e instancës më të ulët kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe se KEK-u kishte përbushur çdo obligim ndaj parashtruesit në datën kur kishte ndaluar së paguari pagesat në emër të pensionit invalidor. Gjykata Supreme i kishte arsyetuar gjetjet e veta, duke u bazuar në Vendimin (nr. 171/133, të 23 tetorit 2003) e KEK-ut sipas të cilit “*pagesa e pensionit ka filluar nga data 01.11.2003 dhe përfundon me 01.12.2008*”.
31. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka hedhur poshtë si të pabazë kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës në rastin e tij, me arsyetimin se “[...] nuk është plotësuar asnjeri prej kushteve ligjore të parapara me nenin 232 të LPK-së [...].”
32. Gjykata vlerëson se procedurat në Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe se të dyja vendimet janë të arsyetuara dhe të argumentuara.
33. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

34. Për më tepër, parashtruesi nuk e ka treguar me qartësi si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat është hedhur poshtë kërkesa e tij për përsëritje të procedurës, përbënин shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, si dhe nuk ka paraqitur prova të cilat arsyetojnë pretendimin për një shkelje të tillë.
35. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të Ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç nëse, dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutshmërinë).
36. Gjykata Kushtetuese përsëritë se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta, apo autoriteteve të tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta ose autoriteteve të tjera publike, aty ku është e mundshme, t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ], Aktvendim i 21 janarit 1999. Shih, gjithashtu, Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI70/11, i 16 dhjetorit 2011, *Parashtrues: Faik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima*).
37. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, e cila dëshmon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovenskei*, Vendim i GJEDNJ-së, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk ka treguar se si nenet e Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, të cilëve u referohet, e mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 48 i Ligjit.
38. Si përbledhje, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkësës për shkelje të të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pasurisë janë të paargumentuara dhe të padëshmuara, dhe për këtë arsy janë qartazi të pabazuara.
39. Mbështetur në arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 10 gusht 2015, njëzëri

## VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Ivan Čukalović



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi

